



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni vjeshtor

Mbledhja plenare e Kuvendit
P- 93
Prishtinë, më 20 dhjetor 2012

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 20 DHJETOR 2012**

Mbledhjen e kryesoi **Xhavit HALITI**, nënkryetar i Kuvendit, ndërsa i ndihmoi **Sabri Hamiti**, nënkryetar i Kuvendit.

Nënkryetari **Xhavit HALITI** i deklaroi të hapura punimet e mbledhjes plenare dhe procedoi me rendin e ditës, të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare.

Për fjalë u paraqit deputetja Flora Brovina, në emër të Grupit të Grave Deputete dhe propozoi që në mbledhjen e sotme Kuvendi ta miratojë një rezolutë për fuqizimin e rolit të gruas.

Ajo theksoi se propozim-rezoluta është rezultat nga Konferenca Ndërkombëtare e Grave, që është mbajtur para disa muajsh në Prishtinë.

Kryesuesi Sabri Hamiti e hodhi në votim propozimin e deputetes Flora Brovina.

Kuvendi, me shumicë absolute të votave e miratoi propozimin e lartshënuar.

Kryesuesi konstatoi që propozim-rezoluta për fuqizimin e rolit të gruas të radhitet si pika e fundit e rendit të ditës në mbledhjen e sotme plenare.

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Deklarime jashtë rendit të ditës paraqitën deputetët: Ramiz Lladrovci, Skënder Hyseni, Visar Ymeri, Xhevdet Neziraj, Suzana Novobërdaliu, Halit Krasniqi, Haki Demolli, Albana Gashi, Gëzim Kelmendi, Zenun Pajaziti, Sabri Hamiti, kryeministri Hashim Thaçi, ministri Enver Hoxhaj, Shaip Muja, Ismet Beqiri dhe Myzejene Selmani, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputetja Albulena Haxhiu parashtroi pyetje për ministrin Bajram Rexhepi në lidhje me atë se mbi cilën bazë ligjore po implementohet e ashtuquajtura IBM në zonat në kufi me Serbinë. A është bërë demarkacioni?

Ministri Bajram Rexhepi nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputeti Afrim Kasolli parashtroi pyetje për ministrin Ramë Buja në lidhje me koston financiare të projektit për përkthimin e literaturës adekuate bashkëkohore dhe pse ka dështuar botimi i atyre veprave në Universitetin e Prishtinës?

Ministri Ramë Buja iu përgjigj pyetjes së deputetit Afrim Kasolli.

Deputetja Salihe Mustafa parashtroi pyetje për ministrin Nenad Rashiq në lidhje me atë se sa punëkërkes brenda vitit kanë marrë shërbime në zyrat e punësimit dhe sa janë trajnuar në kuadër të zyrave të aftësimit profesional të punëkërkesve.

Ministri Nenad Rashiq iu përgjigj pyetjes së deputetes Salihe Mustafa.

Deputetja Time Kadrijaj parashtroi pyetje për ministrin Ferid Agani në lidhje me krijimin e komisionit për verifikimin e shkeljeve të mundshme ligjore në QKUK dhe cilat janë të gjeturat e këtij komisioni.

Ministri Ferid Agani nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputetja Kimete Bytyçi parashtroi pyetje për ministrin Nenad Rashiq në lidhje me atë se sa është numri dhe përqindja e punësimit të personave me aftësi të kufizuara në Republikën e Kosovës.

Ministri Nenad Rashiq iu përgjigj pyetjes së deputetes Kimete Bytyçi.

Deputeti Goran Marinković parashtroi pyetje për ministrin Besim Beqaj në lidhje me afatin kohor të përfundimit të punimeve për ndërtimin e largpërçuesit të ri për furnizim me energji elektrike në komunën e Graçanicës, sipas marrëveshjes ndërmjet kompanisë së KEK-ut dhe Komunës së Graçanicës.

Ministri Besim Beqaj iu përgjigj pyetjes së deputetit Goran Marinković.

Në vazhdim, Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë:

R e n d d i t e

3. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për gjykatat,
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për procedurën përmbartimore,
6. Shqyrtimi i Raportit të punës të Këshillit Gjyqësor të Kosovës për vitin 2011,
7. Shqyrtimi i Propozim-rezolutës për fuqizimin e rolit të gruas.

3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mëparshme

Kuvendi e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes plenare, të mbajtur më 13 dhjetor 2012.

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për gjykatat

Kryesuesi e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për gjykatat.

Ministri Hajredin Kuçi tha se ky projektligj ka për qëllim ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për gjykatat për të siguruar që Ligji për kundërvajtjet të mbetet në fuqi pas hyrjes në fuqi të Ligjit nr.03/L-199 për gjykatat dhe konkretizimi i kompetencave ndërmjet Gjykatës Supreme dhe Gjykatës së Apelit.

Ai ftoi deputetët për miratim në parim të këtij projektligji.

Deputeti Arben Gashi, në emër të Komisionit për Legjislacion, e përkrahu miratimin në parim të këtij projektligji dhe sqaroi se për të mbetur në fuqi Ligji për kundërvajtjet pas hyrjes në fuqi të Ligjit për gjykatat, kërkohet që Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për gjykatat të miratohet në të dy leximet në mbledhjen e sotme plenare, por për këtë çështje kërkohet shmangie nga Rregullorja e Kuvendit, për të cilën duhet të deklarohen me votë deputetët e Kuvendit.

Kryesuesi Sabri Hamiti kërkoi nga deputetët e Kuvendit që, në bazë të nenit 84 të Rregullores së Kuvendit, të deklarohen me votim për shmangie nga Rregullorja e Kuvendit për procedimin në lexim të dytë të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për gjykatat.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 55,
Kundër ----- 1,
Abstenime ----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi e miratoi propozimin për shmangie nga Rregullorja e Kuvendit.

Kryesuesi konstatoi që në mbledhjen e sotme plenare me vendim të deputetëve të Kuvendit, si pikë nr. 8 e rendit të ditës radhitet - **Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për gjykatat.**

Pastaj, kryesuesi e hapi debatin për shqyrtimin në parim të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për gjykatat.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Behar Selimi, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Armend Zemaj, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së; Albulena Haxhiu, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje” ; Ardian Gjini, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së; Gëzim Kelmendi, në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re; Jasmina Zhivković, në emër të Grupit Parlamentar SLS; Myfera Shinik, në emër të Grupit Parlamentar “6+”; diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për gjykatat.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 67,
Kundër ----- 1,
Abstenime ----- 0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për gjykatat.

Mbështetur në nenin 84 të Rregullores së Kuvendit, Kuvendi e ngarkoi Komisionin për Legjislacion që Projektligjin ta shqyrtojë menjëherë dhe Kuvendit t’ia paraqesë raportin me rekomandime për mbledhjen plenare të sotme.

5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për procedurën përmbarimore

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme e kanë shqyrtuar Projektligjin për procedurën përmbarimore dhe Kuvendit ia kanë paraqitur raportet me rekomandime.

Raportin e Komisionit Funkcional e arsyetoi kryetari i këtij komisioni, deputeti Arben Gashi, diskutimi i plotë i të cilit është dhënë në transkript.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Albulena Haxhiu, Arben Gashi dhe ministri i Drejtësisë, Hajredin Kuçi, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi i hodhi në votim amendamentet e propozuara, një nga një.

Kuvendi i miratoi amendamentet: 1, 2, 3, 4, 5, 7, 8, 9, 10, 11, 12 dhe 13.

Kuvendi nuk e miratoi amendamentin nr. 6.

Kryesuesi e hodhi në votim miratimin e Projektligjit për procedurën përmbarimore, me amendamentet e miratuara.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 50,
Kundër ----- 9,
Abstenime ----- 1.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi e miratoi me shumicë votash Ligjin për procedurën përmbarimore.

6. Shqyrtimi i Raportit të punës të Këshillit Gjyqësor të Kosovës për vitin 2011

Deputeti Arben Gashi, në emër të Komisionit FunkSIONAL për Legjislacion tha se si komision kemi shqyrtuar Raportin e punës të Këshillit Gjyqësor të Kosovës për vitin 2011 dhe kemi rekomanduar shqyrtimin dhe miratimin në mbledhje plenare.

Ai në fund e përkrahu Raportin e punës të Këshillit Gjyqësor të Kosovës për vitin 2011.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Halit Krasniqi, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Arben Gashi, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së; Albulena Haxhiu, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje” ; Ardian Gjini, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së; Gëzim Kelmendi, në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re; Jasmina Zhivković, në emër të Grupit Parlamentar SLS; Enis Kervan, në emër të Grupit Parlamentar “6+”, si dhe Hashim Dëshishku dhe Armend Zemaj, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi Xhavit Haliti e hodhi në votim miratimin e Raportit të punës të Këshillit Gjyqësor të Kosovës për vitin 2011.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 53,
Kundër ----- 6,
Abstenime ----- 1.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi e miratoi me shumicë votash Raportin e punës të Këshillit Gjyqësor të Kosovës për vitin 2011.

7. Shqyrtimi i propozim-rezolutës për fuqizimin e rolit të gruas, i propozuar nga deputetja Flora Brovina dhe Grupi i Grave Deputete

Kryesuesi Xhavit Haliti konstatoi se deputetëve u është shpërndarë teksti i propozim-rezolutës për fuqizimin e rolit të gruas, i propozuar nga deputetja Flora Brovina dhe Grupi i Grave Deputete.

Kryesuesi e hapi debatin për shqyrtimin e kësaj pike të rendit të ditës.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës nuk pati të paraqitur për diskutim.

Kryesuesi e hodhi në votim miratimin e propozim-rezolutës për fuqizimin e rolit të gruas, të propozuar nga deputetja Flora Brovina dhe Grupi i Grave Deputete.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 62,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi e miratoi këtë:

R E Z O L U T Ë

Parimet e Prishtinës nga Samiti Ndërkombëtar i Gruas: “Partneriteti për Ndryshim-Fuqizimin e Gruas”, më 4-6 tetor 2012, në Prishtinë

1. Kuvendi inkurajon angazhimin dhe vendosmërinë e institucioneve qendrore dhe lokale, të shoqërisë civile dhe të sektorit privat për zbatimin e dispozitave kushtetuese, ligjit për barazi gjinore dhe ligjeve të tjera relevante dhe planeve shtetërore të veprimit në funksion të zbatimit të parimeve të Prishtinës.
2. Zotohet të fuqizojë monitorimin e zbatimit të legjislacionit dhe politikave për barazi gjinore, duke bërë plotësimin e legjislacionit ekzistues dhe politikave sociale për përmbushjen e parimeve të Prishtinës.
3. Inkurajon Qeverinë dhe institucionet e Republikës së Kosovës që të nxitin dhe mbështesin zbatimin e parimeve të Prishtinës në nivel rajonal dhe global.
4. Inkurajon institucionet e Republikës së Kosovës që të ndërmarrin veprime konkrete dhe të vendosin partneritete me institucionet relevante vendore dhe ndërkombëtare për ta përmbushur objektivin e pjesëmarrjes së gruas në shërbimin civil deri në 50 për qind deri në vitin 2050.
5. Rithekson që pengesat e të gjitha llojeve - politike, sociale, ekonomike, ligjore dhe kulturore - në pjesëmarrjen e plotë të gruas në shoqëri duhet të eliminohen, në mënyrë që të sigurohen të drejtat e patjetërsueshme të gruas.

8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për gjykatat

Kryesuesi tha se Komisioni për Legjislacion, në bazë të nenit 84 të Rregullores së Kuvendit dhe vendimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës për shmangie nga Rregullorja e Kuvendit, e ka shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për gjykatat dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim.

Deputeti Arben Gashi, në emër të Komisionit për Legjislacion, e paraqiti dhe e arsyetoi raportin me rekomandime.

Kryesuesi e hapi debatin për shqyrtimin e kësaj pike të rendit të ditës.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës nuk pati deputetë tjerë të paraqitur për diskutim.

Kryesuesi e hodhi në votim miratimin e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Gjykata.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 67,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi e miratoi Ligjin nr. 04/L-171 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për gjykatat.

Në fund, kryesuesi i njoftoi deputetët se, në pajtim me nenin 37 të Rregullores, me këtë seancë përmbyllet Sesioni vjeshtor i punimeve të Kuvendit, ndërsa Sesioni pranveror fillon të hënën e tretë të muajit janar 2013.

Kryesuesi i mbylli punimet e mbledhjes së sotme, në orën 12:45 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Jakup KRASNIQI

Procesverbalin e hartoi: Drejtoria për Çështje Plenare dhe Procedurale